



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

Proçes-verbali i Mbledhjes së Komisionit të Përhershëm të Këshillit

Data e mbledhjes së Komisionit 25/11/2025

Ora e hapjes së mbledhjes 12:00

Marrin pjesë:

1. z. Altin Habip
2. znj. Ada Përmeti
3. z. Petrika Tollkuçi
4. znj. Alketa Zheku

Marrin pjesë gjithashtu: Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. Eva Naci sekretare e këshillit

Nga ekzekutivi marrin pjesë :

Valbona Ziko, Aida Kristo.

Kryesuesi i mbledhjes është Z. Petrika Tollkuçi

Kryetari i Këshillit/ Kryesuesi i mbledhjes **deklaroi kuorumin** prej 4 Këshilltarësh.

Deklarimi i **konfliktit të interesit**: Nuk ka

Pikat e rendit të ditës.

1. **Projekt-vendim (Pika 7 e rendit të ditës) 7- “PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.”** propozuar nga ekzekutivi.
2. **Projekt-vendim (Pika 8 e rendit të ditës) 8- “PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2027 BASHKIA KORÇË”** propozuar nga ekzekutivi.
3. **Projekt-vendim (Pika 9 e rendit të ditës) 9- “PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026”** propozuar nga ekzekutivi.
4. **Projekt-vendim (Pika 14 e rendit të ditës) 14- “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “CROSS-MOVE- CROSS BORDER SUSTAINABLE MOBILITY EFFORTS IN THE SOUTH-ADRIATIC AREA” NË KUADËR TË PROGRAMIT INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC SI PJESE E BUXHETIT TË BASHKISË.** propozuar nga ekzekutivi.
5. **Projekt-vendim (Pika 15 e rendit të ditës) 15- “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “DIU- DIGITAL INNOVATION UNIT” NË KUADËR TË THIRRJES DIGITAL-2023- EDIH-04 SI PJESE E BUXHETIT TË BASHKISË”.** propozuar nga ekzekutivi.

Drejtuesi i komisionit prezanton projekt-vendimet

U sqaruan nga përfaqësuesit e administratës nevojat për projekt vendimet. U sqarua situata e indeksimit të qerave të banesave sipas legjislacionit në fuqi.

Per pikat 4-5 te diskutuaara nga komisioni, U sqarua se do krijohet fillimisht nje plan mobiliteti i cili do i hape rruge celjes se llogarive ne thesar per te kanalizuar fondet e projekteve. Kontributi i Bashkise 15% dhe ky kontribut do jete ne natyre, ne vleren e punonjesve qe do angazhohen. Per projektin Diu-Digital, Bashkia perfiton fonde per trajnimin e individeve. Projektet jane 2 vjecare.

Per kalendarin e PBA 2027-2029, nuk kishte pyetje dhe diskutime.

Per bursat nuk pati kontestime. Buxheti i Ministrise eshte 18.444.888 lek (280 kuota), kontributi i bashkise (40 kuota) ne vlere 2.634.984 lek. Jane kualifikuar rreth 500 nxenes, nga keta jane perzgjedhur 320 sipas kriterit te percaktuar ne VKB kush ka dorezuar me pare aplikimin.

Per paketen fiskale ka sakesime ne formulim dhe terminologji sipas percaktimeve ligjore dhe nuk ka ndryshime ne paketen fiskale 2026. Ka propozime per perjashtimin e pagesa e tarifave per vajzat dhe grate qe do te hapin biznese te reja gjate 2026 (19-30 vjec) per nje periudhe 2-3 vjecare). Propozohet gjithashtu dhe perjashtimi nga tarifat per nje periudhe 2 vjecare edhe per grate dhe vajzat qe jane viktime te dhunes ne familje me urdher mbrojtjeje.

Mbyllet diskutimi

Përgatitet Vendimi i mbledhjes së Komisionit që do t'i paraqitet këshillit ne seancë.

Vendimi i komisionit u përgatit nga sekretari i Komisionit

Lexohet Projekt-Vendimi i Komisionit nga kryetari

- U votua Projekt vendimi sipas pikës 1: PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.
- U votua Projekt vendimi sipas pikës 2: PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.
- U votua Projekt vendimi sipas pikës 3: PRO 3, KUNDER 0, ABSTENIM 1. Miratohet.
- U votua Projekt vendimi sipas pikës 4: PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.
- U votua Projekt vendimi sipas pikës 5: PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.

Mbyllet mbledhja e Komisionit

Ora e mbylljes së mbledhjes : 13:35.

Nënshkruhet procesverbali i mbledhjes së komisionit

Kryetari i Komisionit

Sekretari i Komisionit



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të
Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.____ datë. 25/11/2025

Nr.____Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve, relacioneve dhe dokumentave shoqërues të projekt-vendimeve, në lidhje me propozimin

1. **Projekt-vendim (Pika 7 e rendit të ditës) 7- “PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERISTAR PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.”** propozuar nga ekzekutivi.
2. **Projekt-vendim (Pika 8 e rendit të ditës) 8- “PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2027 BASHKIA KORÇË”** propozuar nga ekzekutivi.
3. **Projekt-vendim (Pika 9 e rendit të ditës) 9- “PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026”** propozuar nga ekzekutivi.
4. **Projekt-vendim (Pika 14 e rendit të ditës) 14- “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “CROSS-MOVE- CROSS BORDER SUSTAINABLE MOBILITY EFFORTS IN THE SOUTH-ADRIATIC AREA” NË KUADËR TË PROGRAMIT INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC SI PJESË E BUXHETIT TË BASHKISË.** propozuar nga ekzekutivi.
5. **Projekt-vendim (Pika 15 e rendit të ditës) 15- “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “DIU-DIGITAL INNOVATION UNIT” NË KUADËR TË THIRRJES DIGITAL- 2023- EDIH-04 SI PJESË E BUXHETIT TË BASHKISË”.** propozuar nga ekzekutivi

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore e propozimit të projekt-vendimit dhe e vendimit të Komisionit të Përhershëm – a është i mbështetur në ligj propozimi dhe vendimarrja)

ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", i ndryshuar, dhe udhezimit nr.23, date 30.7.2018 "Per Procedurat Standarde te Pergatitjes se Programit Buxhetor Afatmesem te Njesive te Veteqeverisjes Vendore"Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.666 date. I 0.10.2019 Per "Kuotat financiare te ushqimit ne mensa e konvikte dhe percaktimin e kriterave per perfitimin e bursave e te pagesave per nxenesit e arsimit parauniversitar ne institucionet arsimore publike", i ndryshuar, te Vendimit te Keshillit te Bashkisë Korçë nr. 86 date 29.08.2025 per "Miratimin e dokumentacionit dhe procedurave per perfitimin e bursave per nxenesit e arsimit parauniversitar ne Institucionet Arsimore Publike", Ligji nr. 29/2023 "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar; Ligj i nr. 9920, date 19.5.2008 "Per proedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", ndryshuar; Ligji nr.1008 J, date 23.2.2009, "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar; Ligji nr. 10304, date 15.7.2010, "Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise:"; Ligji nr.9975, date 28.7.2008 "Per taksat kombetare", i ndryshuar; Ligji nr. 9482, date 03.04.2006 "Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje", i ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 "Per planitikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Ligji nr.10465, date 29.9.2011 "Per sherbimin veterinar

ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr.8450, date 24.2.1999 "Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre", i ndryshuar; Ligji nr. 57/2020 "Per pyjet", i ndryshuar; Ligji nr. 10279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative", i ndryshuar; Ligji nr. 10296, date 08/07/2010, "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligji nr. I 0463, date 22.9.2011, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar; Ligji nr. 152/2015, date 21.12.2015, "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin"; Ligji nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore"; Ligji nr. 631/2020 "Per permiresimin e zonave te biznesit (Bid)", Ligji Nr. 89/2022 "Per kompetencat dhe detyrat e Policise Bashkiake" Ligjin nr. 50/2023 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"

Vendimi i Keshillit te Ministrave, nr. 783, date 10.11.2011, "Per procedurat e ndarjes se te ardhurave te takses vjetore te 1njeteve te perdorura me njesite e qeverisjes vendore"; VKM nr.7, date 4.01.2012, "Per percaktimin e procedurave dhe te dokumentacionit te nevojshem per arketimin e takses se rentes minerare", i ndryshuar. VKM nr. 970, dt 02.12.2015 "Per percaktimin e pro11edurave dhe te kushteve per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj"; VKM nr.1108, date 30.12.2015 "Per transferimin, nga Ministria e Bujqesise, Zhvillimit rural dhe Administrimit te ujerave te Bashkite, te infrastruktures se ujitjes dhe kullimit, te personelit dhe te asetave te luajtshme e te paluajtshme te Bordeve Rajonale te Kullimit"; VKM nr. 408, date 13.05.2015 "Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit", neni 27 pika 4; VKM nr. 132, date 7.3.2018 "Per Metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme "ndertesa", e bazes se takses per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktimin e hazes se takses, si dhe te kriterave dhe rregullave per vleresimin alternative te detyrimit te takses", i ndryshuar. VKM nr. 475, date 30.7.2021 "Per bashkepuni1nin e njesive te veteqeverisjes vendore me sherbimin veterinar" VKM nr 207. Date 15.03.2017 "Per shpalljen e qendres historike te qytetit te Korçes dhe miratimin e rregullores per mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e te zones se mbrojtur perreth" Udhezim i Ministrit te Financave nr. 1, date 12.1.2007 "Per percaktimin e veprimtarive qe trajtohen si veprimtari, tregtare apo sherbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit te tyre ne organin tatimor"; Udhezim i Ministrit te Financave nr.32, date 31.12.2013, "Per tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel", i ndryshuar. Udhezim i Ministrit te Financave nr.26, date 4.09.2008, "Per taksat kombetare", i ndryshuar. Etj. ligjin nr. 43/2016, "Per maneveshjet nderkombetare ne Republikën e Shqipërisë" vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 775, date 24.9.2010 "Per administrimin e financimeve te huaja ne Republikën e Shqipërisë"; ne VKB m. 176 date 26.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor te vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 te Bashkise Korçë", si dhe ne piken 3.3 te Udhezimit nr.10 date 12.7.2024 "Per regjistrimin, perdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve te financimeve te huaja ne kuadrin e maneveshjeve nderkombetare"

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit – nëse konstatohet që ekziston nevoja për këtë vendim të propozuar dhe çfarë problematike zgjidh ai)

Për pikën 1: Mbeshtetje për arsimin parauniversitar.

Për piken 2: Kalendar i eshte detyrim ligjor sipas legjislacionit per financat.

Pika nr. 3: Funksioni per krijimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

Pika 4 dhe 5: Funksioni i bashkepunimit per realizimin e projekteve me donatore.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet – a ka efekte në buxhet dhe a është parashikuar ap nevojitet buxhet shtesë për zbatimin e vendimit)

Pika 1: Fondi per 280 bursa eshte i Ministrise se Arsimit dhe 40 bursa qe jane nga bashkia jane te planifikuara ne buxhet.

Për piken 2 nuk ka efekte financiare.

Pika 3, krijon te ardhurat per gjithë shpenzimet e bashkise.

Pika 4 dhe 5 nuk ka efekte financiare pasi kontributi i bashkise eshte ne natyre, nepermjet punonjesve qe ka bashkia..

Drejtoria / Sektori përgjegjës (kush është sektori apo drejtoria që do të ngarkohet me zbatimin)

Kryetari I Bashkisë dhe Drejtoria e Finances, Drejtoria e të ardhurave, Sektori i Integritetit European dhe NSHMAÇ.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron zbatimin, raporton dhe sa shpesh)

Kryetari I Bashkisë dhe Drejtoria e Finances, Drejtoria e të ardhurave, Sektori i Integritetit European dhe NSHMAÇ.

Impakti social / grupet që preken: (a ka efekte sociale, pozitive apo negative, grupet që preken dhe impakti që sjell vendimi)

Pika 1. Ka efekt tek personat përfitues (familjet me vështirësi ekonomike dhe sociale që kanë fëmijë në arsimin parauniversitar).

A është objekt i konsultimit publik: (A është projekt-vendimi subjekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015?)

Pika 1, 2, 4 dhe 5: Jo.

Pika 3: Është realizuar konsultimi publik në të gjitha njësitet administrative dhe nuk pati sygjerrime, përveç sygjerrimeve për faljen e tarifave të kategorive të propozuara në projekt vendim. Tarifat janë në të njëjtin nivel me vitin 2025.

Komisioni i Përhershëm për “**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare**”, i mbledhur me datën 25/11/2025, shqyrtoi projekt vendimet, relacionet dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimet për:

1. **Projekt-vendim (Pika 7 e rendit të ditës) 7- “PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.”** propozuar nga ekzekutivi.
2. **Projekt-vendim (Pika 8 e rendit të ditës) 8- “PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2027 BASHKIA KORÇË”** propozuar nga ekzekutivi.
3. **Projekt-vendim (Pika 9 e rendit të ditës) 9- “PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026”** propozuar nga ekzekutivi.
4. **Projekt-vendim (Pika 14 e rendit të ditës) 14- “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “CROSS-MOVE- CROSS BORDER SUSTAINABLE MOBILITY EFFORTS IN THE SOUTH-ADRIATIC AREA” NË KUADËR TË PROGRAMIT INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC SI PJESË E BUXHETIT TË BASHKISË.** propozuar nga ekzekutivi.
5. **Projekt-vendim (Pika 15 e rendit të ditës) 15- “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “DIU-DIGITAL INNOVATION UNIT” NË KUADËR TË THIRRJES DIGITAL- 2023- EDIH-04 SI PJESË E BUXHETIT TË BASHKISË”.** propozuar nga ekzekutivi

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

- T’i propozojë Këshillit Bashkiak, miratimin e projektakteve.

Argumentat e vendimmarrjes janë paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Datë 25/11/2025